



**Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim**

**Raport Vjetor 2016**

## I. PËRMBLEDHJE

Viti 2016 ishte viti i dytë i programit katërvjeçar të certifikimit për mjekët, farmacistët dhe dentistët e punësuar në sektorin publik dhe atë privat të kujdesit shëndetësor. Në këtë vit filloi edhe programi i detyrueshëm i certifikimit për infermierët, mamitë dhe ndihmës farmacistët. Sipas këtij programi profesionistët e sipërpërmendur duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh nga pjesëmarrja në aktivitete të edukimit në vazhdim (AEV), përkatësisht: 120 kredite për mjekët, 60 kredite për stomatologët dhe farmacistët gjatë periudhës 2015-2018, 40 kredite për infermierët, mamitë dhe ndihmësfarmacistët gjatë periudhës 2016-2019.

Oferta e aktiviteteve të edukimit në vazhdim është rritur në vitin 2016. Janë zhvilluar në total 612 aktivitete të akredituara për kategori të ndryshme të profesionistëve të shëndetësisë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kemi një rritje prej rreth 33% të numrit të aktiviteteve të akredituara. Nga këto, 218 kanë qenë aplikime të reja për akreditim, ndërsa të tjerat kanë qenë aktivitete të përsëritura, të akredituara më parë. Kjo rritje e numrit të aktiviteteve shpjegohet kryesisht me futjen e infermierëve në programin e certifikimit por dhe me fuqizimin e kapacitetit të ofruesve. QKEV ka bashkëpunuar ngushtë dhe me projektin Shëndet për të Gjithë (HAP) në drejtim të rritjes së gamës së aktiviteteve të ofruara, me aktivitete të formatit “grupe rishikimi”, si dhe me fuqizimin e kapaciteteve rajonale për planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Edhe në vitin 2016 ofrues kryesorë të aktiviteteve vazhdojnë të jenë shoqatat e profesionistëve dhe organizatat e tjera jopublike si OJQ, institucione akademike, etj. Angazhimi i pamjaftueshëm i institucioneve publike të kujdesit shëndetësor në ofrimin e AEV mbetet një shqetësim i rëndësishëm për mbarëvajtjen e sistemit të edukimit në vazhdim. Konstatohet se drejtuesit e spitaleve dhe qendrave shëndetësore ende nuk e perceptojnë nevojën e investimit në edukimin e personelit si një investim në cilësinë e kujdesit shëndetësor. Edhe pse qendrat shëndetësore kanë një detyrim kontraktual me FSDKSH për përdorimin e 1% të buxhetit për edukimin në vazhdim, ende shumica prej tyre nuk e zbatojnë këtë detyrim. Ndërsa spitalet nuk kanë fond të dedikuar për këtë qëllim. Besojmë se ka vend për rishikim të kontratës së spitaleve me FSDKSH ku të përcaktohet përdorimi i një fondi të dedikuar për edukimin në vazhdim. Monitorimi i zbatimit të këtyre detyrimeve nga FSDKSH merr një rëndësi të vecantë në kushtet kur vërehet neglizhim i zbatimit të tyre. Kujtojmë që ligji “Për Kujdesin Shëndetësor” përcakton detyrimin e institucioneve shëndetësore për të ofruar aktivitete të edukimit në vazhdim për punonjësit e vet në mënyrë që ata të përmbushin minimalisht 30% të numrit të krediteve të kërkuara.

QKEV ka patur në fokus të përpjekjeve të saj garantimin e cilësisë së edukimit në vazhdim, në mënyrë që aktivitetet e zhvilluara t'i përgjigjen nevojave të profesionistëve dhe t'i shërbejnë sa më shumë përmirësimit të performancës së tyre në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, në vitin 2016 QKEV ka forcuar procesin e monitorimit të aktiviteteve të akredituara apo në proces akreditimi. Kështu gjatë vitit 2016 janë monitoruar 103 aktivitete, më shumë se dyfishi i aktiviteteve të monitoruara në vitin pararendës. Nga këto, për 12 aktivitete është anuluar ose refuzuar akreditimi. Arsyeja më e shpeshtë ka qenë shkelja e kriterit të konfliktit të interesit dhe përdorimi i aktivitetit të edukimit në vazhdim për qëllime komerciale. Pesë aktivitete kanë përfituar rritje me 20% të numrit të krediteve të miratuara

paraprakisht për përmbushje maksimale të standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim. Vlerësimi i aktiviteteve cilësore përmes rritjes së numrit të krediteve është një instrument efektiv në promovimin e cilësisë së AEV.

Vlen për tu përmendur se gjatë vitit 2016, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe drejtoritë rajonale spitalore dhe ato të shëndetit publik u krijua grupi i koordinatorëve rajonalë të edukimit në vazhdim me punonjës të DSHP/DRSH, të cilët do të monitorojnë mes të tjerave edhe zbatimin e standardeve të cilësisë së AEV që do të zhvillohen në rrethet/rajonet përkatëse. Mbështetur nga Projekti Shëndet për të Gjithë (HAP), me këtë rrjet të sapongritur të koordinatorëve, si dhe me grupin e specialistëve të edukimit në vazhdim, të emëruar pranë spitaleve rajonale, u kryen gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2016 disa trajnime mbi standardet të akreditimit, certifikimit, monitorimit dhe planifikimit institucional të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Një ndërmarrje e rëndësishme në drejtim të promovimit të cilësisë ka qenë dhe hartimi i projektvendimit: “Për akreditimin e ofruesve të akredituar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim”, bazuar në eksperiencat më të spikatura të vendeve me sistem të zhvilluar për edukimin e vazhduar profesional për profesionistët e shëndetësisë. Ky vendim i ri synon të promojojë cilësinë e edukimit të vazhdueshëm dhe të fuqizojë kapacitetet e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Gjithashtu, në kontekstin e volumit në rritje të aktiviteteve, procesi i akreditimit të ofruesve mundëson menaxhimin më të mirë të procesit akreditimit.


Përsa i takon përmbushjes së kërkesave të programit të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë, mbështetur në informacionin e deritanishëm të dërguar në QKEV vërehet se:

- Numri i profesionistëve të regjistruar për vitin 2016 është rritur me 21,230 infermierë dhe mami, dhe 646 (mjekë, dentistë, farmacistë) duke e çuar numrin e përgjithshëm të tyre në 33,630 profesionistë të regjistruar. Duhet theksuar që ky numër nuk përfaqëson numrin real të atyre profesionistëve që kanë detyrime, pasi nuk është e mundur të bëhet verifikimi individual për statusin e secilit person të regjistruar. Kujtojmë që procesi i regjistrimit është kryer përmes regjistrave të ofruar nga Urdhrat e Profesionistëve, të cilët nuk kanë të dhëna të të sakta. QKEV ka bërë verifikim vetëm në rastet kur regjistrimi është kryer përmes formularit të regjistrimit të QKEV.
- Numri mesatar i krediteve për profesionist për vitin 2016 është 23 kredite për mjek, 12 kredite për stomatolog, dhe 12 farmaciste duke tejkaluar kështu numrin e krediteve minimale të detyrueshme.
- Numri total i krediteve të mbledhura ka shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2016 janë marrë në total 333,160 kredite ose rreth 70 mijë kredite më shumë se një vit më parë.
- 1,548 mjekë, 757 stomatologë, 510 farmacistë dhe 13037 infermierë figurojnë pa kredite të regjistruara në QKEV. Duhet theksuar që ky numër mund të mos pasqyrojë gjendjen reale sepse shumë profesionistë merren me procesin e regjistrimit të krediteve vetëm në momentin e rinovimit të lejes së ushtrimit të profesionit.

## II. AKTIVITETET E AKREDITUARA TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

### 2.1. Oferta e aktiviteteve të edukimit në vazhdim

Për periudhën një vjecare, Janar – Dhjetor 2016 janë zhvilluar në total **612 aktivitete të akredituara** për mjekë, farmacistë, dentistë, infermierë, menaxherë, dhe ekipe multidisciplinare. Në krahasim me vitin e mëparshëm kemi një rritje prej rreth 33% të numrit të aktiviteteve të akredituara. Një paraqitje krahasuese jepet në grafikun e mëposhtëm:



Ndërkohë nga ky total, 218 (35%) kanë qenë aplikime të reja për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim ndërsa 394 aktivitete kanë qenë të përsëritura, këto të fundit më shumë se në cdo vit tjetër deri tani.

QKEV gjatë vitit 2016 ka refuzuar apo anuluar akreditimin për 11 aplikime fillestare për akreditim aktivitetesh gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacioneve përkatëse për mospërbushje të standardeve të akreditimit. Ndërkohë, për sa i takon aktiviteteve të akredituara që kanë kërkuar të përsëriten janë anuluar 3 aktivitete për moszbatim të standardeve të deklaruara.

Një rritje e tillë e ofertës së aktiviteteve të akredituara, besojmë se lidhet me rritjen e interesit të profesionistëve dhe vecanërisht me përfshirjen e infermiereve dhe mamive në proces. Gjithashtu edhe kapacitetet e ofruesve të edukimit në vazhdim janë në rritje.

### 2.2 Aktivitetet të edukimit në vazhdim sipas llojeve


Për sa i përket llojeve të aktiviteteve të akredituara gjatë vitit 2016, bazuar në formatin e tyre, numrin më të lartë e kanë pasur trajnimet të ndjekura nga konferencat e leksionet. Duhet thënë se pavarësisht faktit që shumë aktivitete deklarohen të formatit trajnim, në praktikë janë ende të pakta ato aktivitete që arrijnë të

realizojnë cilësisht standardet e këtij formati, ku duhet të ketë më shumë seanca me punë praktike nga vetë pjesëmarrësit në to.

Rritja e mënjëhershme e kërkesës nga grupi i madh i infermiereve dhe mamive për kredite, ka bërë që dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitete të ndryshme të jetë e lartë, duke i shtyrë ofruesit të organizojnë më shumë aktivitete të formatit leksione dhe konferenca (116 në total), ku mundësohet një pjesëmarrje më masive se në trajnime apo tipe të tjera aktivitetelesh.

Gjatë vitit 2016 është vërejtur gjithashtu një rritje e numrit të aktiviteteve të edukimit në distancë. Këtu dallohen disa ofrues që kanë realizuar përsëritjen e aktiviteteve të akredituara të këtij formati

Më poshtë paraqiten aktivitetet e akredituara sipas llojit



### 2.3 Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas ofruesve

Në lidhje me ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, edhe në vitin 2016 vazhdojnë të mbizotërojnë aktivitetet e zhvilluara nga shoqatat e profesionistëve dhe organizatat e tjera jopublike si ofrues kryesorë. Tabela përmbledhëse paraqet aktivitetet e ofruara nga kategoritë e ndryshme të ofruesve:

Kategoria e ofruesve	Nr i Aktiviteteve
Spitale Private	16
Spitale, DSHP, QSH Publike	76
MSH dhe ISHP	39
Institucione akademike	29
Organizata jofitim prurëse	226
Shoqata mjekësore	231
<b>TOTAL</b>	<b>612</b>

Angazhimi i pamjaftueshëm i institucioneve publike të kujdesit shëndetësor në ofrimin e aktiviteteve mbetet një shqetësim i rëndësishëm për mbarëvajtjen e sistemit të edukimit në vazhdim. Përgjithësisht bëjnë pak institucione, që kanë vazhduar të ofrojnë AEV për stafet e tyre. Gjithashtu vecojmë qendrat shëndetësore në Fier dhe Dibër që kanë ofruar me mbështetjen e projektit Shëndet për të Gjithë, aktivitete të formatit “grupe të rishikimit” dhe të “forumeve të menaxherëve”. Janë realizuar rreth 28 aktivitete të këtyre formateve gjatë vitit 2016.

Aktivitetet institucionale të llojeve të tjera apo aktivitete nga spitale publike dhe private paraqiten në detaje tabelës më poshtë:

Ofruesi	Numri i Aktiviteteve
QSUT - Klinika e vartesisë alkologjike	1
Klinika Stomatologjike Universitare	1
QSH nr 1 Fier	1
Spitali Amerikan Tirane	3
Spitali Psikiatrik Elbasan	3
Spitali Rajonal Durres	3
Spitali Salus	9
Spitali rajonal Korce	1
QSH Dajc	2
Spitali i Traumes	1
QSUT	10
DRSH Durres	11
Spitali Permet	1
Qendra Shendetesore ABC	19
QSUT, Sherbimi i Hematologjise	1
Spitali Rajonal Shkoder	1
Spitali Rajonal Gjirokaster	1
QSH Nr. 4 Durres	1
QKMZHRF	1

QSH Burrel	2
Klinika Nuova	1
QSH Frakull	1
QSH Clirim, Fier	1
<b>Total i institucioneve te kujdesit shëndetësor:</b>	<b>76</b>

Janë ofruar gjithashtu aktivitete të planifikuara dhe organizuara nga DSHP-të e rretheve, për stafe të ofruesve të shërbimit parësor në rrethët përkatëse, ashtu sic janë organizuar dhe një numër i konsiderueshëm aktiviteteve nga ISHP dhe MSH.

<b>Ofruesi</b>	<b>Numri i Aktiviteteve</b>
Autoriteti Shëndetësor Rajonal	7
DRSHP Fier	1
DRSH Gjirokaster	2
DSHP Berat	1
DSHP Gjirokaster	2
ISHP	21
Ministria e Shëndetësisë	18
DSHP Librazhd	1
DRSHP Vlore	4
DSHP Kolonje	1
DSHP Shkoder	1
DSHP Sarande	1
<b>Total i drejtorive rajonale dhe MSH</b>	<b>60</b>

Lind nevoja e përfshirjes më të gjërë të institucioneve akademike publike, për të dhënë një kontribut më të dukshëm në procesin e edukimit në vazhdim. Gjatë vitit të shkuar ato kanë organizuar vetëm 12 aktivitete të tilla, ku një aktivitet ishte i formatit on-line. Ndërkohë është vënë re që institucionet akademike private kanë qënë më aktive me organizimin e një numri prej 18 aktiviteteve.

<b>Institucionet Akademike Private</b>	<b>Numri i Aktiviteteve</b>
Albanian University	4
UZKM	14
<b>Total i Institucioneve Akademike Private:</b>	<b>18</b>
Fakulteti i Mjekesise Tirane	8
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan, Departamenti Infermierise	1
Universiteti Shkodres " Luigj Gurakuqi"	1
Universiteti Aleksander Moisiu, Durres	1
<b>Total i Institucioneve Akademike Publike:</b>	<b>11</b>
<b>Total i Institucioneve Akademike</b>	<b>29</b>

Gjatë vitit 2016 spikatin si ofrues aktivitetesh shoqatat mjekësore, me mbi 70 % të totalit të aktiviteteve të ofruara, të ndjekura nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor dhe ofrues privatë të AEV . Ndër këto shoqata , bazuar në numrin e aktivitete të ofruara në një vit kalendarik, mund të përmendim Shoqatën Komëtare të Shëndetit Publik me 79 aktivitete, Insituti Shqiptar i Shëndetit dhe Zhvillimit Shoqëror me 45 aktivitete, Shoqata e Diabetit me 18 aktivitete, Shoqata Shqiptare e Urgjencave Mjekësore me 17 aktivitete, etj. Për sa i takon ofruesve privatë të këtyre aktiviteteve, bazuar në numrin e aktiviteteve të ofruar, dallon organizata jo fitimprurëse ISSAT, me 63 aktivitete.

Nga institucionet shëndetësore përmendim shërbimet e QSUT “Nënë Tereza” në Tiranë, Spitali Rajonal Durrës dhe SUOGJ “Koço Gliozheni”, të cilët kanë ofruar më shumë aktivitete për punonjësit e tyre dhe jo vetëm.

Shiko tabelën më poshtë:

<b>Ofruesi</b>	<b>Numri i Aktiviteteve</b>
Caritas Shqiptar	5
Fondacioni Shendetesor ABC	2
ISSAT	63
Qendra e trajnimit profesional mjeksor "Santa Maria"	7
Qendra per Popullsine ne Zhvillim	1
Shoqata Kujdesi Shendetesor Familjar	28
Sëiss Foundation for Innovation	44



ACA Albanian Community Assisst	3
Shoqata e Farmakoekonomise dhe Studimit te Rezultateve ne shendet e Shqiperise	1
Qendra Vullnetare e Emergjencave civile	3
Instituti Shqiptar i Shendetit dhe Zhvillimit Shoqror	3
Projekti "Shendet per te gjithe"	2
Qendra Komunitare Psiko-terapeutike	1
Emergency Response Albania	1
Fondacioni Spitalor i Nenes dhe Femijes	10
Shoqata Shqiptare per Kerkim dhe Edukim Shendetesor	3
Opera della Provvidenza Madoninna del Grappa	1
Qendra Shqiptare per Zhvillimin e Shendetit Mendor	1
Shoqata Genera	4
Qendra Shqiptare per Popullsine dhe Zhvillimin	6
Shoqata e Femijeve dhe te Rinjve me Diabet	1
Qendra "Njesia Shqiptare e Bioetikes"	1
<b>Total I OJF</b>	<b>191</b>
<b>SHDVSH</b>	<b>2</b>
Shoqata Dentare Shqiptare	4
Shoqata e Ortodonteve Shqiptare	3
Shoqata Shqiptare e Pneumologeve	4
Shoqata Kombetare e Infektivologjise	1
Shoqata Kombetare e Shendetit Publik	79
Shoqata Oro Maksilo Faciale	1
Shoqata Pediatrike Shqiptare	2
Shoqata Shqiptare e Alergologjise dhe Imunologjise Klinike	2
Shoqata Shqiptare e Kardiologjise	3
Shoqata Shqiptare e Neurologjise	1

Shoqata Shqiptare e ORL "Besim Zyra"	1
Shoqata e Diabetit	18
Shoqata oftalmologjike shqiptare	1
Shoqata "Per nje Shqiperi te shendeteshme"	5
Instituti Shqiptar i Shendetit dhe Zhvillimit Shoqeror	45
Shoqata e toksikologeve shqiptar "Albtox"	1
Shoqata Shqiptare e Urgjencave Mjekesore	17
MAYA	5
Shoqata shqiptare e studimit dhe aplikimit te ultratingulli ne mjeksi dhe biologji	6
Albanian society ultrasound in medicine and biology& Klinika Erton	1
Shoqata Shqiptare e Mjekesise Riprodhuese	1
Shoqata shqiptare e otorinolaringologjise	1
Shoqata e Semundjeve te Ralla	1
EUASSO	1
<b>Total i Shoqatave mjekësore</b>	<b>206</b>

Ndër urdhrat e profesionistëve vecohen Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë (UISH) dhe Urdhri i Farmacistëve.


Në fund të raportit paraqitet një tabelë e plotë me të dhënat të aktiviteteve të akredituara spër të gjitha kategoritë e ofruesve të përmendura më lart. Anex 1

#### **2.4 Aktivitetet e akredituara sipas kategorive të profesionistëve të shëndetësisë**

Për sa i takon kategorisë së profesionistëve të shëndetësisë që vihen në fokusin e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, viti 2016 ruan të njëjtën tendencë me vitin paraardhës. Ka gjithnjë e më shumë aktivitete me fokus kategorinë e mjekut të përgjithshëm/familjes dhe infermerit të kujdesit parësor shëndetësor. Gjithashtu dhe aktivitetet me target grup ekipet multidisiplinare spikatin në tabelën e mëposhtme (*shih Tabelën më poshtë*). Vihet re një rritje e numrit të aktiviteteve për farmacistët në krahasim me një vit më parë, si dhe një aktivizim gjithnjë e më i madh i Urdhrit të Infermierëve në organizimin e aktiviteteve të akredituara me fokus grupin e infermiereve dhe mamive. Ndërkohë

pavarësisht se në vlerë absolute është rritur numri i aktiviteteve për dentistët, krahasimisht me kategoritë e tjera të pjesëmarrësve, ai mbetet sërish i ulët.


Më poshtë paraqiten të dhënat e aktiviteteve sipas kategorive të profesionistëve që fokusojnë:



## 2.5 Financimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim

Një tjetër element që ka rëndësi në analizën e aktiviteteve të akredituara është dhe mënyra e financimit të tyre. Gjatë vitit 2016 është rritur numri i aktiviteteve të financuara nga kuotat e pjesëmarrjes. Gjithashtu ka një rritje të dukshme të aktiviteteve të financuara nga fonde dhe donacione të ndryshme. Këtu duhet përmendur dhe financimi projekti Shëndet për të Gjithë (HAP) i një sërë aktiviteteve në 2016. Këto aktivitete janë ofruar nga një sërë institucionesh shëndetësore në Fier dhe në Peshkopi. Një rritje ka pësuar dhe numri i aktiviteteve të financuara nga sponsorë tregtarë.

Është tepër e nevojshme të theksohet rëndësia e angazhimit të institucioneve shëndetësore për financimin e edukimit të vazhdueshëm. Konstatohet se drejtuesit e spitaleve dhe qendrave shëndetësore ende nuk e perceptojnë nevojën e investimit në edukimin e personelit si një investim në cilësinë e kujdesit shëndetësor. Edhe pse qendrat shëndetësore kanë një detyrim kontraktual me FSDKSH për përdorimin e 1% të buxhetit për edukimin në vazhdim, ende shumica prej tyre nuk e zbatojnë këtë detyrim. Besojmë se ka vend për rishikim të kontratës së spitaleve me FSDKSH ku të përcaktohet përdorimi i një fondi i dedikuar për edukimin në vazhdim. Monitorimi i zbatimit të këtyre detyrimeve nga FSDKSH dhe merr një rëndësi të vecantë në kushtet kur vërehet neglizhim i zbatimit të tyre.



### III. MONITORIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË SË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Gjatë vitit 2016 një vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të zbatimit të standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim përmes procesit të monitorimit të aktiviteteve të akredituara apo në proces akreditimi. Në total gjatë vitit 2016 janë monitoruar **gjithsej 103 aktivitete**. Tipet e aktiviteteve të monitoruara kanë qenë: konferenca, trajnime, seminare, leksione, grupe rishikimi, aktivitete të edukimit në distancë.

Bazuar në shkeljet e konstatuara gjatë monitorimit, 8 prej këtyre aktiviteteve iu është reduktuar numri i krediteve dhe 4 aktiviteteve iu është anuluar ose refuzuar akreditimi. Ndërkaq, për përmbushje maksimale të standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim, 5 aktivitete kanë përfituar rritje me 20% të numrit të krediteve të miratuara paraprakisht.

Reduktimi i numrit të krediteve për aktivitetet e monitoruara ka ndodhur për arsyet e mëposhtme:

- Mosrespektimi i programit të aktivitetit dhe orareve të tij, sipas seancave përkatëse. Ndryshimi i lektorëve në raport me ata të deklaruar në programin e aktivitetit, pa njoftim paraprak.
- Kushtet fizike të ambjentit; të papërshtatshme për zhvillimin e aktivitetit, apo mungesa e mjeteve logjistike të domosdoshme për zhvillimin e tij.
- Përdorimi i metodave jo të duhura pedagogjike nga ana e lektorëve për përmbushjen e objektivave të aktivitetit. Mungesa e ndërveprimit mes lektorit/trajnerit me pjesëmarrësit, moskryerja dhe mospërfshirja e pjesëmarrësve në seancat e pyetje, diskutime të parashikuara në program.
- Monitorimi jo i plotë nga ana e ofruesit mbi prezencën dhe kohëqëndrimin efektiv të profesionistëve në aktivitet. Sjellja e listave të padiferencuara sipas kohëqëndrimit efektiv të tyre.

Vendimi për anulimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim pas monitorimit është marrë për shkelje të konstatuara të VKM Nr. 788 datë 22.09.2015, pikave 1.5.3.1 dhe 1.5.3.4 si dhe të “Udhëzuesit për procedurat dhe kriteret e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”. si :

- moskryerja e aktivitetit në datën e caktuar, pa njoftim paraprak në QKEV;
- shkelja e kriterit të konfliktit të interesit ose përdorimi i aktivitetit të edukimit në vazhdim për qëllime tregtare.

Falë një ekperience disa vjeçare bashkëpunimi mes ofruesve të aktiviteteve dhe QKEV-së, shumë aspekte të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve nga ana e organizatorëve tashmë janë më të qarta, gjithashtu sugjerimet specifike ose vërejtje të vazhdueshme që i janë dërguar organizatoreve përmes raporteve të monitorimit, kanë rritur cilësinë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim sipas standardeve të kërkuara nga legjislacioni, sidomos përsa i përket konfliktit të interesit dhe përdorimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim në funksion të objektivit të edukimit, dhe jo marketimit të produkteve.

Zbatimi i standardeve mbetet ende një sfidë për aktivitetet e edukimit në distancë.

Problemet më të hasura gjatë procesit të monitorimit janë:

- Ndryshimet në program ose vendndodhje.

Ndryshimet në program ose vendndodhje të aktivitetit pa lajmëruar QKEV-në është një fenomen që shpesh shpjegohet me neglizhimin ndaj rregullave dhe kërkesave të QKEV-së. Ndryshimet në program kanë qenë të lidhura me mosrespektimin e afateve kohore të paracaktuara sipas seancave, mbylljen e aktivitetit përpara afatit të deklaruar, ndryshimin e lektorëve/trajnerëve, duke ndikuar kështu në cënimin e cilësisë së aktiviteteve të organizuara.

- Monitorimi i pjesëmarrësve.

Për aktivitete të llojit konferencë mbetet ende sfidë si për organizatorin, ashtu dhe për QKEV-në monitorimi i saktë i numrit të pjesëmarrësve, monitorimi i kohës efektive të ndjekjes së aktivitetit dhe sjellja e listave të diferencuara sipas monitorimit me objektivet të kohë-qëndrimit për secilin pjesëmarrës.

- Teknikat pedagogjike.

Kriteri i teknikave pedagogjike mbetet një kriter i papërbushur në një masë të konsiderueshme aktiviteteve. Me gjithë angazhimin serioz të organizatorëve, aspektet e mësimdhënies janë kryesisht tradicionale dhe jo inovative. Forma më e zgjedhur është leksion teorik duke e bërë jo interesant për pjesëmarrësit dhe në disa raste pjesëmarrjen vetëm formale. Në lidhje me konferencat, edhe pse prezantimet janë cilësore mungon impenjimi për t'i përfshirë pjesëmarrësit në pyetje e diskutime si nga vetë lektorët ashtu dhe nga moderatorët. Ky fenomen ka shoqëruar në disa raste edhe aktivitete të tipit trajnime, apo seminare. Në konferenca është vënë re gjithashtu tendenca për të mos përkthyer prezantimet e lektorëve të huaj në gjuhën shqipe, ose dhe prezantimet e lektorëve shqiptarë në gjuhë të huaj me argumentimin se pjesëmarrësit nuk kanë nevojë për përkthim.

Aktivitetet e edukimit në distancë, edhe për shkak se organizimi i tyre është një risi për Shqipërinë, paraqesin deri më tani mangësi kryesisht në konceptimin pedagogjik (përfshirë përdorimin e mjeteve vizuale, hapësirat ndërvepruese) dhe në monitorimin e punës së

pjesëmarrësve në këto aktivitete përtej testit të njohurive para dhe pas aktivitetit. Mungon dukshëm ndërveprimi lektor pjesëmarrës duke zbehur bashkëbisedimin dhe thellimin në kërkesa sqaruese përsa i përket temës së trajtuar në aktivitet.

- Konflikti i interesit.

Vihet re një përmirësim i dukshëm nga ana e ofruesve në zbatimin e kriterit të konfliktit të interesit nga fillimi deri më sot. E megjithatë vijon të mbetet ende problem për disa ofrues të cilët mbështeten financiarisht për herë të parë nga sponsor tregëtar.

- Vlerësimi i aktivitetit.

Është vënë re nga monitorimi se pjesa më e madhe e ofruesve nuk i japin rëndësinë që i takon procesit të vlerësimit të aktivitetit. Meqënëse kjo kërkesë nuk është më fleksibël, por është bërë e detyrueshme nga VKM përkatëse, ky proces ka nisur të kryhet rregullisht.

Vlen për tu përmendur se gjatë vitit 2016, falë një bashkëpunimi të frutshëm me Ministrinë e Shëndetësisë u krijua grupi i koordinatorëve rajonale me punonjës të DSHP/DRSH, të cilët do të monitorojnë mes të tjerave edhe zbatimin e standardeve të cilësisë së AEV që do të zhvillohen në rrethet/rajonet përkatëse. Mbështetur nga Projekti HAP, me këtë rrjet të sapo ngritur të koordinatorëve, si dhe me grupin e specialistëve të edukimit në vazhdim, të emëruar pranë spitaleve rajonale, u kryen gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2016 disa trajnime mbi standardet të akreditimit, certifikimit, monitorimit dhe planifikimit institucional të aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim.

Në të njëjtën kohë, detyrat e këtyre punonjësve në mbështetje të QKEV për zbatimin e standardeve të edukimit në vazhdim në rrethe/rajone u formalizuan me Urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 12 dhe Nr. 13, datë 09.01.2017.

Të gjitha problematikat e konstatuara gjatë punës sonë në vitin 2016, sugjerojnë ndryshime e përmirësime të mëtejshme si në punën e vetë QKEV-së ashtu dhe në atë të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Rrjedhimisht disa objektiva të Sektorit të Monitorimit dhe Cilësisë për vitin në vazhdim janë:

- Monitorimi i një numri mbi 100 aktivitete të planifikuara dhe që do të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm.
- Rritja e aftësive për të monitoruar dhe kontribuar në cilësinë e aktiviteteve të edukimit në distancë që do të organizohen nga ofrues vendas.
- Bashkërendimi i punës me rrjetin e koordinatorëve rajonalë të sapo krijuar pranë DSHP/DRSH dhe me specialistët e edukimit në vazhdim pranë spitaleve rajonale me qëllim zbatimin me objektivitet të detyrave të tyre, përcaktuar me Urdhërat e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 12 dh 13, datë 09.01.2017, sa i takon procesit të monitorimit.
- Mbështetja e rrjetit të koordinatorëve rajonalë për të rritur numrin e aktiviteteve të monitoruara në rrethe/ rajone në krahasim me periudhën paraardhëse.
- Organizimi i aktiviteteve rifreskuese mbi zbatueshmërinë e standardeve të cilësisë së monitorimit të aktiviteteve të EV.
- Monitorimi i vlerësimit të aktivitetit nga stafi i QKEV-së me anë të formularëve të vlerësimit për pjesëmarrësit sa herë që kjo gjë është e mundur për disa nga aktivitetet e monitoruara. Përfundimet e këtij vlerësimi bëhen pjesë e rezultateve të monitorimit dhe procesit të akreditimit të aktivitetit.
- Nevojat për rritjen e kapaciteteve monitoruese cilësore të stafit për aktivitetet e EV në përgjithësi dhe sidomos për ato të edukimit në distancë.

#### IV. ECURIA E PROGRAMIT TE CERTIFIKIMIT

##### IV.1 Regjistrimi i profesionistëve të shëndetësisë

Në fund të vitit 2016 numri i profesionistëve ka arritur në **33,630** të regjistruar nga të cilët 761 janë profesionistë Jo-Aktivë dhe 15 853 profesionistë janë pa kredite. Nga këto: 13037 janë infermierë, 1,548 janë mjekë, 757 stomatologë dhe 510 farmacistë. Në grupin e profesionistëve Jo-Aktivë përfshihen ata profesionistë që janë në periudhë specializimi, raport leje lindje apo shkëputje nga puna për një periudhë kohore më shumë se 4 muaj si dhe ata që kanë pezulluar licencën pranë urdhrit përkatës. Këto të dhëna ndryshojnë në periudha të caktuara gjatë ciklit e sidomos në përfundim të tij pasi profesionistët vijnë të deklarojnë aktivitetet individuale ku ata kanë marrë pjesë.

Regjistrimi i infermierëve dhe mamive në programin e certifikimit është bërë mbi bazën e listave të marra nga Urdhri i Infermierit si dhe nga regjistrimet individuale të kryera nëpërmjet formularëve të regjistrimit. Risjellim në vëmendje se regjistri i profesionistëve paraqet parregullsi gjë e cila reflektohet dhe në raporte. Megjithë përpjekjet e bëra për përmirësimin e të dhënave të regjistrimit të certifikimit gjatë vitit 2016, përsëri vërehen pasaktësi për pasojë dhe raportet e nxjerra nuk pasqyrojnë gjendjen reale. Raporti i certifikimit për vitin 2016 është përgatitur mbi bazën e profesionistëve aktivë dhe atyre që kanë marrë kredite. Numri i profesionistëve sipas profesioneve paraqitet si më poshtë:

Profesioni	Numri i Profesionistëve në fund të 2016		
	AKTIV	JO-AKTIV	TOTAL
Mjek	6,075	605	6,622
Stomatolog	2,849	94	2,874
Farmacist ndihmës farmacist	2,715	50	2,694
Infermier & mami	21,230	12	20,963
<b>Total</b>	<b>32,869</b>	<b>761</b>	<b>33,630</b>

Në raport nuk janë përfshirë profesionistët pa kredite numri i të cilëve në total arrin në 15853 nga të cilët 1,548 janë mjekë, 757 stomatologë , 510 farmacistë dhe 10037 infermierë. Në tabelën më poshtë profesionistët pa kredite janë ndarë sipas sektorëve publik dhe privat..

Profesioni	Profesionistëve pa kredite në fund të 2016		
	Sektori Publik	Sektori Privat	TOTAL
Mjek	964	584	1,548
Stomatolog	129	628	757
Farmacist ndihmës farmacist	48	462	510
<b>Total</b>	<b>1,141</b>	<b>1,674</b>	<b>2,815</b>

Për kategorinë e infermierëve VKM Nr 789 datë 22/09/2015 nuk ka përcaktuar detyrim minimal vjetor dhe viti 2016 është viti i parë i ciklit të infermierëve dhe mamive. Kjo gjë ka bërë që infermierët të mos paraqesin interes që në vitin e parë të ciklit. Një arsye tjetër që kjo kategori profesionistësh nuk e ka përmbushur numrin minimal të rekomanduar për vit mund të jetë dhe mungesa e aktiviteteve të organizuar enkas për infermierë. Nuk kemi të dhën për punësimin e infermierëve.

Infermierë	2016	
Pa kredite	13,037	61%
Mbi Minimum (1-10)	3,068	14%
Mbi Rekomandim >10	5,126	24%

#### IV.2 Numri total i krediteve dhe numri mesatar i krediteve për profesionist

Numri mesatar i krediteve për profesionist për vitin e dytë të ciklit 2015-2018 është 23 kredite për mjekë, 12 kredite për stomatologë, 12 kredite për farmacistë. Në nivel kombëtar të gjithë profesionistët e kanë tejkaluar detyrimin minimal të detyrueshëm për vitin 2016 por krahasuar me vitin 2015 vihet re se niveli mesatar i krediteve për profesion është më i ulët. Përlllogaritja e krediteve mesatare sipas profesioneve merr në konsideratë dhe profesionistët me 0 kredite për këtë arsye është dhe i ulët.

Profesioni	Numri i Profesionistëve Aktivë		Kreditet e Marra			Kreditet mesatare	
	2015	2016	2015	2016	Total	2015	2016
Mjek	5,846	6,075	170,136	142,577	<b>252,752</b>	<b>29</b>	<b>23</b>
Stomatolog	2,569	2,849	53,902	35,200	<b>78,832</b>	<b>21</b>	<b>12</b>
Farmacist	2,458	2,715	37,911	33,566	<b>62,018</b>	<b>15</b>	<b>12</b>
Infermiere	550	21,230	4,233	121,817	<b>77,572</b>	<b>7.7</b>	<b>6</b>
<b>Total</b>	<b>11,423</b>	<b>32,122</b>	<b>266,182</b>	<b>333,160</b>	<b>599,342</b>		



Situata paraqitet më e mirë për vitin 2016 nëse përlloriten kreditet mesatare vetëm për ata profesionistë që kanë marrë kredite. Vihet re një rritje e ndjeshme e krediteve mesatare për profesion për ata profesionistë që janë marrë me edukimin e vazhdueshëm.

Profesioniste me kredite	Numri i profesionisteve	Kreditet e marra	Kreditet mesatare
Mjek	4,227	142,577	34
Stomatolog	1,795	35,200	20
Farmacist	1,921	33,566	17
Infermiere	21,230	121,817	6
<b>Total</b>	<b>32,122</b>	<b>333,160</b>	

#### IV.3 Përmbushja e detyrimit minimal vjetor sipas profesionit

Analiza e përmbushjes së kriterit të detyrimit minimal vjetor është bërë për profesionistët me kredite. Numri i mjekëve të cilët nuk kanë përmbushur kërkesat e programit të certifikimit mjekë që kanë më pak se 10 kredite arrin në 593 pra është më i lartë se në vitin 2015 gjë e cila vërehet dhe në tabelën e mëposhtme.

Analiza e profesionistëve Aktivë që kanë marrë kredite				
	2015		2016	
<b>Mjek</b>	<b>4,403</b>		<b>4,227</b>	
Nën Minimum (1 - 9)	497	11%	593	14%
Mbi Minimum (10-30)	1,797	41%	1,888	45%
Mbi Rekomandim >30	2,109	48%	1,746	41%

Për stomatologët që kanë më pak se 5 kredite për vitin 2016 situata paraqitet më e mirë numri i profesionistëve me detyrim minimal të pa kryer arrin në 2% të profesionistëve.

Analiza e profesionistëve Aktivë që kanë marrë kredite				
	2015		2016	
<b>Stomatolog</b>	<b>1,845</b>		<b>1,795</b>	
Nën Minimum (1 - 5)	6	0%	43	2%
Mbi Minimum (5-15)	430	23%	883	50%

Mbi Rekomandim >15	1,409	76%	869	48%
--------------------	-------	-----	-----	-----

Farmacistët me detyrim minimal të pa kryer arrijnë në 4% të numrit të përgjithshëm.

<b>Analiza e profesionistëve Aktivë që kanë marrë kredite</b>				
	<b>2015</b>		<b>2016</b>	
<b>Farmacist</b>	<b>1,933</b>		<b>1,921</b>	
Nën Minimum (1 - 5)	30	2%	76	4%
Mbi Minimum (5-15)	805	42%	1,002	52%
Mbi Rekomandim >15	1,098	57%	843	44%

#### **IV.4 Kreditet sipas specialiteteve**

Sipas të dhënave të regjistrit të certifikimit 16% e mjekëve të përgjithshëm që kanë kredite nuk e kanë kryer detyrimin minimal prej 10 kreditesh në vit. Nga të dhënat e përpunuara sipas specialiteteve, profesionistët me specialitet onkolog e kanë kryer detyrimin në masën 100% ndërsa ata me specialitetet alergolog dhe reanimator zënë vendin e dytë më detyrim të kryer në masën 98% dhe 97% gjithnjë duke patur në vëmendje ata profesionistë që janë marrë me edukim të vazhdueshëm pra që kanë kredite.

Specialiteti me % më të lartë të detyrimit minimal të pa kryer është mjek higjienist me 35% të totalit të mjekëve me kredite. Mjekë me detyrim të pa kryer ka nga cdo specialitet. Një situatë më e hollësishme sipas specialiteteve paraqitet në tabelën më poshtë.

Mjekët Aktiv Sipas Specialitetit - Total (Publik dhe Privat)								
Mjekët	Numri sipas Statusit të Kreditimit			TOTAL	%	% sipas Statusit të Kreditimit		
	Nën Minimu m <10	Mbi Minimu m (10- 30)	Mbi Maksimu m >30			Nën Minimu m <10	Mbi Minimu m (10- 30)	Mbi Maksimu m >30
Alergolog	1	16	27	44	1.0%	2%	36%	61%
Anestezist	9	74	58	141	3.3%	6%	52%	41%
Biokimist	6	26	51	83	2.0%	7%	31%	61%
Dermatolog	10	26	20	56	1.3%	18%	46%	36%
Endokrinolog	9	22	32	63	1.5%	14%	35%	51%
Epidemiolog	7	13	10	30	0.7%	23%	43%	33%
Gastrohepatolog	11	37	22	70	1.7%	16%	53%	31%
Hematolog	5	11	22	38	0.9%	13%	29%	58%
Higjenist	7	9	4	20	0.5%	35%	45%	20%
I pergjithshem	304	876	698	1,878	44.4%	16%	47%	37%
Imazherist	15	36	48	99	2.3%	15%	36%	48%
Infeksionist	9	24	27	60	1.4%	15%	40%	45%
Kardiolog	34	54	73	161	3.8%	21%	34%	45%
Kirurg	7	80	71	158	3.7%	4%	51%	45%
Mikrobiolog	7	28	23	58	1.4%	12%	48%	40%
Nefrolog / Urolog	6	26	30	62	1.5%	10%	42%	48%
Neonat Reanimator	1	7	21	29	0.7%	3%	24%	72%
Neurolog	11	25	15	51	1.2%	22%	49%	29%
Obst/Gjinekolog	23	109	76	208	4.9%	11%	52%	37%
Okulist	6	31	26	63	1.5%	10%	49%	41%
Onkolog	0	6	9	15	0.4%	0%	40%	60%
ORL	2	24	42	68	1.6%	3%	35%	62%
Ortoped	3	24	34	61	1.4%	5%	39%	56%
Pediater	21	89	89	199	4.7%	11%	45%	45%
Pneumolog	17	21	46	84	2.0%	20%	25%	55%
Psikiater	2	8	9	19	0.4%	11%	42%	47%
Reumatolog	7	18	19	44	1.0%	16%	41%	43%
Shendeti Publik	3	11	14	28	0.7%	11%	39%	50%
Tjeter	22	157	129	308	7.3%	7%	51%	42%
Urgjence	5	14	10	29	0.7%	17%	48%	34%
<b>Total</b>	<b>570</b>	<b>1,902</b>	<b>1,755</b>	<b>4,227</b>	<b>100%</b>	<b>13%</b>	<b>45%</b>	<b>42%</b>

## V. KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2016 QKEV ka punuar për rritjen e përmirësimin e komunikimit me të gjithë aktorët, ne vecanti me profesionistët. QKEV ndan rregullisht informacion me profesionistët në lidhje me kriteret dhe detyrimet e programit të certifikimit, gjendjen aktuale të krediteve si nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ashtu edhe përmes postës elektronike, rrjeteve sociale, mediave si të shkruara dhe audiovizive.

Në portalin elektronik të qendrës në mënyrë periodike janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e akredituara nga QKEV, datat, vendet ku do të zhvillohen dhe gjithë të dhënat relvante në mënyrë që profesionistët të kenë mundësi të informohen për aktivitetet që ndodhin, të zgjedhin ato që përmbushin më mirë nevojat e tyre. Në portalin elektronik të QKEV në mënyrë periodike janë pasqyruar të gjithë vendimet e marra mbledhjet e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm.

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim me mbështetjen e Projektit Zviceran “Shëndet për të gjithë” ka organizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh informuese si:

- Takim informues me ofruesit e edukimit në distancë për prezantimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktivitetëve të edukimit në vazhdim.
- Tre Ëorkshope me temë: “Programi i certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë dhe planifikimi institucional i aktivitetëve të edukimit në vazhdim” me pjesëmarrjen e specialistëve të ngarkuar për edukimin në vazhdim nga DSHP e qarqeve, ASHR.
- Tryezën e Rrumbullakët për prezantimin dhe diskutimin e projektvendimit të kriterëve, standardeve dhe procedurave të akreditimit me ofrues të aktivitetëve të edukimit në vazhdim me të gjithë aktorët e interesuar.
- Trajnime me specialistët e DSHP / DRSH dhe specialistët e edukimit në vazhdim pranë spitaleve rajonale, për planifikimin e aktivitetëve të edukimit në vazhdim, akreditimin e aktivitetëve dhe monitorimin e aktivitetëve të edukimit në vazhdim.
- Me mbështetjen e Projektit Zviceran “Shëndet për të gjithë” ka organizuar një trajnim të ofruesve të aktivitetëve të edukimit në vazhdim mbi përdorimin e platformës së re online për edukimin në vazhdim.

## **VI. SFIDA PER VITIN 2017**

Forcimi i mëtejshëm i rolit të institucioneve shëndetësore që ato të përmbushin detyrimet ligjore në lidhje me edukimin në vazhdim mbetet sfidë madhore e sistemit. Nga ana e saj, QKEV do të vazhdojë të punojë për zhvillimin e kapaciteteve të koordinatorëve të edukimit në vazhdim në DSHP/DRSH dhe spitalet rajonale në mënyrë që ata të kryejnë sa më mirë detyrat e tyre, përfshirë planifikimin e aktivitetëve të edukimit në vazhdim për personelin e tyre. Megjithatë, pa angazhimin efektiv të drejtuesve të spitaleve dhe qendrave shëndetësore si dhe pa funksionimin e mekanizmave të llogaridhënies për detyrat që u ngarkon ligji për edukimin në vazhdim, nuk mund të sigurohet mbarëvajtja e sistemit. Viti 2017 si vit elektoral nuk favorizon forcimin e rolit të insitucioneve.

Rritja e kapaciteteve të ofruesve në drejtim të standardeve të aktivitetëve të edukimit në vazhdim përfaqeson gjithashtu një sfidë të rëndësishme. Fillimi i zbatimit të procesit të akreditimit të

ofruesve besojmë se do të ndihmojë dhe promojë rritjen dhe forcimin e kapacitetit të tyre. Praktika e akreditimit nxjerr në pah një nevojë ende të madhe të ofruesve aktualë për të rifreskuar njohuritë në lidhje me vlerësimin e nevojave, planifikimin, vlerësimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe për të respektuar kritere të tjera të akreditimit.

Zhvillimi i mëtejshëm i alternativës së edukimit në distancë ka qenë dhe mbetet sfidë e sistemit të edukimit në vazhdim. Përpjekjet dhe ndërhyrjet e filluara disa vjet më parë nga projekti “Sistemi i Zhvillimit Profesional” nuk kanë vijuar në dy tre vitet e fundit. Nëse nuk do të ketë një mbështetje serioze për rritjen e kapaciteteve të ofruesve për edukimin në distancë dhe sigurimin e një infrastrukture të nevojshme për këtë formë edukimi, nuk parashikohet ndonjë zhvillim i ndjeshëm në këtë drejtim. QKEV beson se kjo është një fushë që kërkon më shumë mbështetje teknike.

Nga ana e saj QKEV duhet të forcojë më tej rolin e saj monitorues për cilësinë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në përgjithësi dhe sidomos për ato të edukimit në distancë. Duhet të vijojë bashkërendimi i punës me rrjetin e koordinatorëve rajonale të sapo krijuar pranë DSHP/DRSh dhe me specialistët e edukimit në vazhdim pranë spitaleve rajonale, me qëllim zbatimin e detyrave të tyre, sidomos përsa i takon procesit të monitorimit.

## Anex 1

<b>Ofruesi</b>	<b>Numri i Aktiviteteve</b>
Albanian University	4
UZKM	9
UZKM, Elbasan	5
Total I Institucioneve akademike private:	18
Fakulteti i Mjekesise Tirane	8
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan, Departamenti Infermierise	1
Spitali Universitar i Traumes	1
Universiteti Shkodres " Luigj Gurakuqi"	1
Universiteti Aleksander Moisiu, Durres	1
Total I institucioneve akadem publike:	12
QSUT - Klinika e vartesise alkologjike	1
Klinika Stomatologjike Universitare	1
QSH nr 1 Fier	1
Spitali Amerikan Tirane	3
Spitali Psikiatrik Elbasan	3
Spitali Rajonal Durres	1
Spitali Salus	9
Spitali rajonal Korce	1
QSH Dajc	2
QSUT	10
DRSH Durres	11
Spitali Permet	1

Qendra Shendetesore ABC	19
QSUT, Sherbimi i Hematologjise	1
Spitali Rajonal Shkoder	1
Spitali Rajonal Gjirokaster	1
QSH Nr. 4 Durres	1
QKMZHRF	1
QSH Burrel	2
Klinika Nuova	1
QSH Frakull	1
QSH Clirim, Fier	1
Total institucioneve te kujdesi shendetesor:	73
Autoriteti Shendetesor Rajonal	7
DRSHP Fier	1
DRSH Gjirokaster	2
DSHP Berat	1
DSHP Gjirokaster	2
ISHP	21
Ministria e Shendetesise Shqiptare	18
Spitali Librazhd	1
DRSHP Vlore	4
DSHP Kolonje	1
DSHP Shkoder	1
DSHP Sarande	1
Total I drejtorive rajonale dhe MSH/	60
Caritas Shqiptar	5
Fondacioni Shendetesor ABC	2
ISSAT	63
Qendra e trajnimit profesional mjeksor "Santa Maria"	7

Qendra per Popullsine ne Zhvillim	1
Shoqata Kujdesi Shendetesor Familjar	28
Sëiss Foundation for Innovation	44
ACA Albanian Comunity Assisst	3
Shoqata e Farmakoekonomise dhe Studimit te Rezultateve ne shendet e Shqiperise	1
Qendra Vullnetare e Emergjencave civile	3
Instituti Shqiptar i Shendetit dhe Zhvillimit Shoqeror	3
Projekti "Shendet per te gjithë"	2
Qendra Komunitare Psiko-terapeutike	1
Emergency Response Albania	1
Fondacioni Spitalor i Nenes dhe Femijes	10
Shoqata Shqiptare per Kerkim dhe Edukim Shendetesor	3
Opera della Provvidenza Madoninna del Grappa	1
Qendra Shqiptare per Zhvillimin e Shendetit Mendor	1
Shoqata Genera	4
Qendra Shqiptare per Popullsine dhe Zhvillimin	6
Shoqata e Femijeve dhe te Rinjve me Diabet	1
Qendra "Njesia Shqiptare e Bioetikes"	1
Total I OJF	191
SHDVSH	2
Shoqata Dentare Shqiptare	4
Shoqata e Ortodonteve Shqiptare	3
Shoqata Shqiptare e Pneumologeve	4
Shoqata Kombetare e Infektivologjise	1
Shoqata Kombetare e Shendetit Publik	79
Shoqata Oro Maksilo Faciale	1
Shoqata Pediatrike Shqiptare	2



Shoqata Shqiptare e Alergjologjise dhe Immunologjise Klinike	2
Shoqata Shqiptare e Kardiologjise	3
Shoqata Shqiptare e Neurologjise	1
Shoqata Shqiptare e ORL "Besim Zyma"	1
Shoqata e Diabetit	18
Shoqata oftalmologjike shqiptare	1
Shoqata "Per nje Shqiperi te shendeteshme"	5
Insituti Shqiptar i Shendetit dhe Zhvillimit Shoqeror	45
Shoqata e toksikologeve shqiptar "Albtox"	1
Shoqata Shqiptare e Urgjencave Mjekesore	17
MAYA	5
Shoqata shqiptare e studimit dhe aplikimit te ultratingulli ne mjeksi dhe biologji	6
Albanian society ultrasound in medicine and biology& Klinika Erton	1
Shoqata Shqiptare e Mjekesise Riprodhuese	1
Shoqata shqiptare e otorinolaringologjise	1
Shoqata e Semundjeve te Ralla	1
EUASSO	1
Total I Shoqatave mjekësore	206
UFSH	7
UISH	8
Urdhri i Mjekute te Shqiperise	1
Total I Urdherave	16
Shoqata e Distributoreve te materialeve dhe paisjeve dentare	1
Akademia Shqiptare e Mjekeve te Familjes	15
certipass digital skills	1
Kryqi i Kuq Shqiptar	5
Dilo Dental Center	5
I Care	1

Schatz Institute	3
LGBT	1
CLASS DENT	1
Kolegji Shqiptar Mjekesise	2
Save the Children Albania	1
Total tjetër	36
TOTALI	612

